



Datë: 19.03.2026

Numër Protokolli: 1453/2026

A.nr.125/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës A.nr.125/2026, të datës 02.02.2026, të parashtruar nga ankuesja Xh.G nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 19.03.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.125/2026 e datës 02.02.2026, e parashtruar nga ankuesja Xh.G, ashtu që aprovohet pretendimi ankimor se organi i punësimit nuk ka marrë për bazë dëshmitë e ofruara me rastin e shqyrtimit të kërkesës së datës 19.01.2026 lidhur me përvojën e punës së ankueses, ndërsa lënda kthehet në *rishqyrtim* dhe *rivendosje* te organi i njëjtë.

II. Anulohet Përgjigja me referencë:14-117/01-8997/26 të datës 20.01.2026 e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës.

III. Obligohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, sipas **pikës I** të dispozitivit, ashtu që të rishqyrtoj dhe vendos për kërkesën e palës ankuese dhe të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi duke marrë për bazë pikëpamjet e dhëna juridike si në këtë vendim.

IV. Refuzohet Pretendimi ankimor i palës ankuese lidhur me kërkesën e saj për pagesën e përvojës së punës nga 0.25% në 0.5% të pagës.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Ankuesja Xh.G (tutje referuar vetëm: *ankuesja*), më datë 02.02.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.125/2026, kundër Përgjigjes me referencë:14-117/01-8997/26 të datës 20.01.2026 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.06.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa, kjo e fundit më datë 13.02.2026, ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 559/2026 të datës 02.02.2026, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Përgjigjen me referencë:14-117/01-8997/26 të datës 20.01.2026 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës; Kopjen e librezës së punës me nume regjistri:4203/85; Letër konfirmimin e datës 09.06.2025 të Agjencisë Kosovare të Privatizimit; Vërtetimin e lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale i datës 05.03.2024; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 06.02.2026; Përgjigje në kërkesë e datës 13.02.2026; Akt Emërimit e datës 01.02.2017; Kërkesën e datës 19.01.2026; Vendimin e Njesisë së Burimeve Njerëzore i datës 16.05.2024.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses sa i përket kërkesës që t'i njihet përvoja e punës për periudhën kohore nga viti 1992-1999 është pjesërisht e bazuar dhe lënda duhet të kthehet në ***rishqyrtim***, sepse:

Nga shqyrtimi i provave të administruara, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesja sipas Akt Emërimit të datës 01.02.2017, mban pozitën "*Zyrtare për emergjenca*", në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publik, *Mbrojtje dhe Shpëtim* të Komunës së Prishtinës, ndërsa Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore përmes Vendimit Nr.305 të datës 16.05.2025, ia ka njohur përvojën e punës në kohëzgjatje prej 21 vite e 10 muajsh.

Ankuesja, me datë 19.01.2026 i është drejtuar Njesisë për Menaxhimin e Komunës së Prishtinës me kërkesën që t'i njihet përvoja e punës për periudhën kohore nga viti 1992-1999 me arsyetimin se një çështje e tillë është trajtuar nga Gjykata Kushtetuese përmes Aktgjykimit me shifër ne rastin K035/24 dhe Ligjit Nr.08/L-248.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me datë 20.01.2026 i ka kthyer ankueses Përgjigjen me referencë:14-117/01-8997/26, përmes të cilës bëhet e ditur se Njësia e Burimeve Njerëzore me datë 16.05.2025 përmes Vendimit Nr.305 ia ka njohur përvojën e punës për të cilat ekzistojnë dëshmi respektive, dhe po përmes përgjigjes në fjalë i është referuar nenit 6 paragrafi 2, nën paragrafi 2.1 të Rregullores (QRK) Nr.05/2023 për Pagën Bazë dhe Përvojën në Punë për të Punësuarit në Sektorin Publik, me theksin se përvoja e punës para qershorit 1999 duhet të dëshmohet përmes njërit prej dokumenteve të mëposhtme: librezës së punës me numrin amëz të të siguruarit (të kompletuar), dëshmime të ofruara nga njësia përkatëse e pensioneve në ministrinë përgjegjëse për fushën e pensioneve, ose ndonjë nga dëshmitë e tjera të llastuara në kuadër të kësaj pike.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se organi i punësimit në mënyrë të padrejtë e ka refuzuar kërkesën e saj për njohjen e përvojës së punës, pasi që kjo çështje është e rregulluar nga Gjykata Kushtetuese përmes Aktgjykimit me shifër ne rastin K035/24 dhe Ligjit Nr.08/L-248, me kërkesën që t'i njihet përvoja e punës për periudhën kohore nga viti 1990-1999, të kryhet pagesa e përvojës së punës në mënyrë retroaktive për periudhën kohore nga 1990-1999 duke marr parasysh edhe kompensimin e diferencës së pagesës nga 0.25% në 0.5% në përputhje me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Me qëllim të konstatimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses, meqenëse e njëjta i referohet përvojës së punës në periudhën kohore para vitit 1999, Kolegji i Këshilli mori përbazë dispozitat e aplikuara nga nenin 6 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.05/2023 për Pagën Bazë dhe Përvojën në Punë për të Punësuarit në Sektorin Publik, ku përcaktohet se: *“Përvoja e punës dëshmohet përmes njëres prej dëshmime si vijon: 2.1.përpara qershorit 1999: 2.1.1.dëshmime të ofruara nga njësia përkatëse e pensioneve në ministrinë përgjegjëse për fushën e pensioneve; 2.1.2.librezës së punës me numrin amëz të të siguruarit (të kompletuar); 2.1.3.dëshmisë që vërteton se i ka paguar kontributet ai dhe/ose punëdhënësi ku ka punuar, dëshmi të cilat detyrimisht do të verifikohen nga zyrtarët e njësisë përkatëse të pensioneve në ministrinë përgjegjëse për fushën e pensioneve, sipas dispozitave të aplikueshme nga sigurimi pensional dhe invalidor i Kosovës deri në vitin 1989; 2.1.4.regjistrin të pagave; 2.1.5.kartelës së pagave; 2.1.6.vendimit apo kontrata për themelimin e marrëdhënies së punës; 2.1.7.formularit për paraqitje në sigurim dhe ndërprerje të sigurimit (Ml,M-2); 2.1.8.vendimit për pagën, rritje dhe harmonizim; 2.1.9.vendimit për pushimin vjetor; 2.1.10. vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës; 2.1.11. vendimit në origjinal të ish Bashkësisë Vetëqeverisëse të Interesit (BVI) së punësimit e në të cilin janë të shënuara të dhënat për stazhin e punës; 2.1.12. vërtetimit nga Agjencia Kosovare për Privatizim, për stazhin e punës në ndërmarrjet shoqërore; 2.1.13. dëshmisë-çertifikatës për pagesën e kontributeve të lëshuara nga organi kompetent komunal në rastin e zëhtarëve privat; 2.1.14. vërtetimit të lëshuar në origjinal nga kompania private me vulë dhe nënshkrim, të shoqëruar me një deklaratë nën betim”*, dhe erdhi në përfundimin se për t'iu njohur nëpunësit përvoja e punës sipas kësaj kategorie është e mjaftueshme të sigurohen dëshmi që argumentojnë një fakt të tillë, dhe jo domosdoshmërisht të gjitha në mënyrë kumulative, kurse në rrethanat e rastit konkret në provat e dërguara nga palët në procedurë si nga ankuesja, po ashtu edhe dhe nga organi i punësimit, dëshmohet fakti se ankuesja posedon librezën e punës me numër regjistri:4203/24 të datës 30.10.1985, po ashtu posedon vërtetimin e datës 09.06.2025 të lëshuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit lidhur me marrëdhënien e punës së ankueses për periudhën kohore para vitit 1999 dhe deri në vitin 2006, ashtu që

konfirmohet se e njëjta është larguar nga puna me datë 28.02.1992, si dhe posedon edhe Vërtetimin e datës 05.03.2024 të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përmes të cilit konfirmohet përvoja e punës së ankueses para vitit 1999.

Pas konstatimit të dhënë si më lartë, Kolegji i Këshillit në mbështetje të dispozitave të nenit 47 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 ndërlidhur me nenin 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“1. Arsytimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsytimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyeve pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”*, dhe mbi këtë bazë konstatoi se Përgjigja me referencë:14-117/01-8997/26 e datës 20.01.2026 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës është akt i paligjshëm sikurse përcaktohet me nenin 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 të të njëjti ligj siç përcaktohet se: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ;”* pasi që përgjigja e dhënë e datës 20.01.2026 nuk ka pasqyruar saktë nëse me rastin e konfirmimit të punës prej 21 vitesh e 10 muaj janë përfshirë edhe periudha kohore para vitit 1999, sipas dëshmive që i kanë dërguar në këtë procedurë administrative referuar librezës së punës me numër regjistri:4203/24 të datës 30.10.1985, vërtetimit të datës 09.06.2025 të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Vërtetimit të datës 05.03.2024 të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, gjegjësisht përgjigjes së dhënë i mungon arsyetimi si dhe baza ligjore se pse në rastin konkret janë nuk janë të zbatueshme dëshmitë e paraqitura.

Prandaj, nga se u tha si më lartë me qëllim të kthimit të ligjshmërisë Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi, ashtu që Përgjigja me referencë:14-117/01-8997/26 të datës 20.01.2026 të Njesisë së Burimeve Njerëzore është anuluar ndërsa lënda e ankueses është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje, kurse pretendimi ankimor i ankueses se organi i punësimit nuk ka marrë përbazë dëshmitë e ofruara është i bazuar. Kolegji i Këshillit thekson faktin se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me rastin e shqyrtimit të kërkesës së ankueses të datës 19.01.2026 lidhur me përvojën e marrëdhënies së punës, duhet të shqyrtojë të gjitha dëshmitë e ofruara nga pala e të cilat janë cekur edhe në këtë vendim dhe të nxjerrë akt administrativ duke u mbështetur në ligjin material që trajton çështjen e përvojës së punës.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, në lidhje me pretendimin e ankueses sa i përket përvojës së punës që të paguhet nga 0.25% në 0.5% të pagës, ka konstatuar se ky pretendim është i pabazuar, **sepse:**

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses që përvoja e punës të paguhet nga 0.25% në 0.5% të pagës, duke marrë parasysh edhe kompensimin në mënyrë retroaktive sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, Kolegji i Këshillit iu referua nenit 6 paragrafit 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, me të cilin është përcaktuar se: “6. Paga bazë rritet në bazë të përvojës së punës, në masën: 6.1. zero pikë njëzetë e pesë për qind (0.25%) për çdo vit të plotë pune, deri në pesëmbëdhjetë vite (15) punë; dhe 6.2. zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune, mbi pesëmbëdhjetë vite (15) punë”, dispozita këto të cilat i janë nënshtruar vlerësimit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese, më ç’rast, kjo e fundit, me Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23, në pikën II të dispozitivit ka konstatuar së paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojta e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ndërsa, në pjesën arsyetues gjegjësisht në pikët 380 dhe 381 ka sqaruar: 380. Gjykata ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) dhe paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit të kontestuar janë në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht me të drejtën në gëzimin paqësor të pronës dhe barazinë para ligjit. Kjo, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, ndër të tjera, sepse (i) zbritja joproportionale e nivelit të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Kosovës është në kundërshtim të plotë me parimet kushtetuese, ligjore, parimet relevante ndërkombëtare dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe përtej cenimit të të drejtave respektive individuale, rezulton edhe në cenim të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe vlerave të Republikës së Kosovës;...ndërsa (v) përgjysmimi i shtesës për përvojën e punës për të gjithë kategorinë e funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve për pesëmbëdhjetë (15) vitet e para të përvojës së punës, kufizon të drejtat dhe liritë themelore të tyre, pa asnjë qëllim legjitim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 të Kushtetutës. 381. Thënë këtë, sipas sqarimeve të dhëna më sipër ndërlidhur dhe me efektin e Aktgjykimeve të Gjykatës, kjo e fundit (i) nuk do të shfuqizojë paragrafin 6 të nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit të kontestuar, ndërsa (ii) do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar. 382 Kjo sepse, lidhur me paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar që ndërlidhet me shtesën mbi pagën për përvojën e punës, Ligji i kontestuar në paragrafin 1 të nenit 45 të tij, ka shfuqizuar edhe Ligjin nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, i cili përfshin nenin 18 (Shtesa mbi pagën për përvojën e punës) sipas të cilit, për çdo vit të përvojës së punës të kaluar në shërbimin civil dhe jashtë tij, përveç përvojës së kaluar në punë praktike, nëpunësit civil sipas këtij ligji i takon e drejta shtesë në pagën bazë prej zero pikë pesë përqind (0,5%). Shpallja e pavlefshme e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar i kombinuar me faktin që Ligji nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë shfuqizohet gjithashtu përmes paragrafit 1 të nenit 45 të Ligjit të kontestuar, do të rezultonte në zbrazëti ligjore, përkitazi më të drejtën për shtesa mbi pagën për përvojën e punës. Për pasojë, duke balancuar parimin e sigurisë juridike dhe të drejtat dhe liritë themelore, Gjykata do të lë në fuqi paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në periudhën prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, duke i përcaktuar detyrimin Kuvendit, që brenda kësaj periudhe të ndryshojë dhe/ose plotësojë paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në pajtim me konstatimet e këtij Aktgjykimi. Në ndryshimin dhe/ose plotësimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, Kuvendi duhet të ketë parasysh që efektet e ndryshimit/plotësimit të tij në kontekst të lartësisë së shtesës për përvojën e punës burojnë që nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi”.

Andaj, duke qenë se Kuvendi i Kosovës brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese nuk ka bërë plotësim/ndryshimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Këshilli në mungesë të këtij rregullimi ligjor, nuk ka juridiksion ligjor që të detyroj institucionet publike të bëjnë kompensimin e përvojës së punës për zyrtarët publikë dhe rrjedhimisht mbi këtë bazë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me kompensimin për përvojën e punës sikurse pretendohet në ankesë, konstaton se pretendimi ankimor mbi rrethanat ekzistuese nuk ka mbështetje ligjore dhe si i tillë refuzohet në këtë fazë.

Theksuar si me lart, Kolegji i Këshillit duke u bazuar ne nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike:Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda:A.nr.125/2026, datë 19/03/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, Xh.G;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.